



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Nr. Prot

Tiranë, më 27/04/2011

VENDIM

NR. 2, datë 27/04/2011

Për zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit

Në mbështetje të nenit 19, pikës 2 (ç), të Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në mbledhjen e datës 27.04.2011, pasi diskutoi nevojën për të interpretuar kërkesën e njëjësive ekonomike për të kaluar nga regjimi i zbatimit të SNRF në regjimin e zbatimit të detyrueshëm të SKK-ve,

VENDOSI:

1. Njësitë ekonomike, të cilat në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr 9228, datë 29.04.2004, neni 4, pika 4 (c), zbatojnë në mënyrë të detyrueshme SNRF, lejohen të zbatojnë në periudha të mëpashme SKK vetëm nëse nuk plotësojnë për 2 (dy) vjet rresht kriteret e VKM 742, datë 07/11/2007, për të ardhurat vjetore ose numrin e të punësuarve.
2. Të publikojë këtë vendim në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.
3. Të njoftojë për dijëni Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Pjesëmarrës në mbledhje:

1. Jorgji Bollano,
2. Nezir Haldeda
3. Sotiraq Dhamo,
4. Ylber Bezo
5. Selman Lamaj
6. Agim Binaj
7. Flutura Kalemi
8. Arjana Dyrmishi
9. Frederik Çuçllari

Kryetar i KKK

Nënkryetar

anëtar

anëtar

anëtar

anëtar

anëtare

anëtare

anëtar

Adresa: Bul. “Dëshmorët e 4 Shkurtit” Nr. 6, pranë ILDKP, Tiranë

Tel: 042 220 499 Fax: 042 220 466 Site: www.kkk.gov.al E_mail: info@kkk.gov.al